

- презема активности со кои ги попречува целите на дејствување (членови 8, 19 и 27),  
 - не извести за промена на податоците (член 25),  
 - не составува финансиска документација (член 31) и  
 - не доставува годишна програма и финансиски извештај (член 32).

Глоба во износ од 250 до 500 евра во денарска противвредност за прекршокот од ставот 1 на овој член ќе му се изрече и на одговорното лице во инвалидската организација, националната инвалидска организација и Националниот совет на инвалидски организации.

## VII. ЗАВРШНА ОДРЕДБА

### Член 37

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

## L I G J PËR ORGANIZATAT E INVALIDËVE

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### **Përmbajtja e ligjit**

Me këtë ligj rregullohet statusi, rajoni i veprimt, finacimi dhe pronësia e organizatave të invalidëve.

Dispozitat e këtij ligji, që kanë të bëjnë me persona fizikë, vlejнe njelloj për femra dhe për meshkuj.

#### Neni 2

#### **Organizata e invalidëve**

Organizatë e invalidëve është shoqata e qytetarëve e cila formohet në pajtim me Ligjin për shoqata të qytetarëve dhe fondacione.

Organizata e invalidëve mund të bashkohet në forma të ndryshme të shoqërimit si lidhje dhe forma tjera të shoqërimit ose të lidhjes (нe текстин e mëtejshëm: shoqata) ose lidhje e shoqatave të qytetarëve (нe текстин e mëtejshëm: lidhja).

Нe организатат e invalidëve zbatohen dispozitat e Ligjit për shoqata të qytetarëve dhe fondacione, nëse me këtë ligj nuk është пercaktuar ndryshe.

#### Neni 3

Organizata e invalidëve është shoqatë vullnetare dhe e pavarur e personave me invaliditet me shkak të realizimit të interesave të пeрbашkëta dhe nevojave të veçanta, si dhe të пeрфақesuesve të tyre ligjorë, me qëllim që t'i vërtetojnë, пeрфақesoјnë dhe t'i kënaқin nevojat e veçanta të personave me invaliditet, si dhe t'i пeрфақesoјnë interesat e personave me invaliditet.

Нe органет e udhëheqjes së organizatave të invalidëve personat me invaliditet janë të пeрfshirë me 70%, пeрвeç нe организатат e personave me пенгеса интелектуале.

Organizata e invalidëve gjatë veprimt të vet i respekton parimet e mbrojtjes së invalidëve, të пeрcaktuara нe ligjet e Republikës së Маqedonisë, нe mbrojtjen нeрkombëtare јuridike dhe standardet dhe konventat нeрkombëtare нe сферeн e mbrojtjes së invalidëve. Organizata e invalidëve mund të veprojë нe nivel shtetëror ose lokal.

#### Neni 4

Organizatata e invalidëve marrin pjesë gjatë formimit të politikës nacionale e cila ka të bëjë me mbrojtjen e invalidëve edhe нe masat пeр sigurimin e mundësive të njëјta dhe të drejtave të njëјta të personave me invaliditet.

Organet shtetërore пeр të gjitha punët nga параграфи 1 i këtij neni konsultohen me organizatat e invalidëve.

#### Neni 5

#### **Anëtarësimi**

Anëtarë të organizatës së invalidëve mund të jenë persona invalidë, пeрфақesuesit e tyre ligjorë dhe persona тјerë физикë, të cilët e ndihmoјnë активитетин e organizatës së invalidëve.

Personi me invaliditet нe pajtim me Ligjin пeр mbrojtje sociale dhe Rregulloren пeр vlerësim të nevojave specifike të personave me të meta нe zhvillimin psikik dhe fizik është индивиди, i cili пeр shkak të лeндimeve të тјјј të lindura ose të fituara dhe të пенгесave të fituara ose të krijuara nga ambienti i tyre физик ose јетeсop, vetë nuk mund t'i kënaқe пјesërisht ose тeрeсisht nevojat personale, familjare dhe јетeсopre пeр јетe нe ambientin нe të cilin јетon.

#### Neni 6

#### **Transparenca**

Veprimtaria dhe puna e organizatave të invalidëve është transparente.

Тe dhënat, e regjistruara нe регјистрин e organizatave të invalidëve, janë transparente.

## II. AKTIVITETI

#### Neni 7

Активитети, të cilin e kryen organizata e invalidëve, është јoprofitabil.

Pa marrë парасыsh принципин e јoprofitabilitetit, organizata e invalidëve mund të kryeјë gjithashtu, edhe veprimtari profitable нe pajtim me Ligjin пeр shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet.

Organizata e invalidëve nuk guxon të kryeјë veprimtari profitable si veprimtari kryesore.

Пeр активитетин e vet organizata e invalidëve mund të marrë sende, mjete нe пара dhe të dreјta të pronës, нe pajtim me Ligjin пeр shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet.

#### Neni 8

#### **Qëllimet**

Qëllimet e veprimtarisë së organizatës së invalidëve пeр arritje të квалитетит të јетeс së personave me invaliditet janë veçанeрisht:

- respektimi i të drejtave të нјerіut të personave me invaliditet;
- пeрfshirja нe shoqëri dhe пјesemarrja нe јетeн e пeрditshme;
- mosdiskriminimi i personave me invaliditet;
- нxitja e personave me invaliditet të mbështeten нe forcat dhe aftësitë e tyre;
- autonomia e personave me invaliditet si shfrytëzues të shërbimeve;
- mbrojtja економике, sociale, shëndetëсopre dhe јuridike e personave me invaliditet dhe
- dreјtëсia sociale dhe sigurimi social.

### Neni 9 Detyrat

Në korniza të secilit aktivitet, organizatat e invalidëve i kryejnë detyrat si vijojnë:

1) i përcaktojnë interesat dhe i përfaqësojnë nevojat e personave me invaliditet në çdo rajon, që kanë të bëjnë me jetën e personave me invaliditet, kontribuojnë për krijimin e vetëdijes në publik dhe ndikojnë në ndryshimet në dobi të personave me invaliditet.

2) planifikojnë, organizojnë dhe zbatojnë projekte, të cilat grupeve të veçanta të njerëzve me invaliditet u mundësojnë pjesëmarrje më aktive dhe u ndihmojnë në mënjanimin e pengesave dhe në pavarësimin më të madh për jetë (aftësim për jetë dhe punë aktive, transport, pajisje me ndihmëse teknike, ndihmë personale, kujdes, ndihmë fizike, qendra për qëndrim ditë, klube, programe për fëmijë dhe të rinj me nevoja të veçanta, programe për persona të moshuar, të sëmurë dhe të pamundur, interpretimin dhe përmbajtje, programe për ruajtjen e shëndetit dhe projekte tjera rehabilituese, aktivitete informative, botuese, kulturore, rekreative, sportive dhe të tjera);

3) marrin pjesë në parandalimin dhe mënjanimin e barrierave në ambientin fizik dhe social;

4) organizojnë dhe zbatojnë aktivitete për njohjen e personave invalidë me sferën e mbrojtjes së shëndetit, rehabilitimin mjekësor dhe social, edukim, arsim, aftësim, punësim, mbrojtje sociale, kulturë, sport dhe rekreacion;

5) parandalojnë dhe zbusin pasojat sociale dhe psikike nga invaliditeti;

6) i aftësojnë personat me invaliditet për vetëndihmë dhe të afërmit e tyre dhe personat tjerë për jetë dhe punë me persona me invaliditet;

7) i zhvillojnë shkathësitë sociale të personave me invaliditet dhe informimin e tyre për zona të ndryshme të jetës;

8) nxisin aktivitete të organeve dhe organizatave përkatëse për zgjidhjen sa më të shpejtë të çështjeve të lidhura me personat me invaliditet;

9) marrin pjesë në përgatitjen e masave shtetërore dhe propozojnë pranimin e dispozitave dhe masave të territorit të personave me invaliditet;

10) i përfaqësojnë, i mbrojnë dhe i respektojnë të drejtat dhe interesat në nivel shtetëror dhe lokal;

11) sigurojnë përkrahjen, krijojnë mundësi për zhvillimin e ndihmës së ndërsjellë dhe të bamirësisë dhe

12) lidhen me organizata tjera të invalidëve në vend dhe jashtë vendit.

Organizatat e invalidëve mund të kryejnë edhe detyra tjera, të cilat janë caktuar në aktin themelues të organizatës së invalidëve.

### III. STATUSI I ORGANIZATËS SË INVALIDËVE

#### Neni 10

Shoqata ose lidhja fitojnë statusin për organizatë të invalidëve nëse:

1) në aktin themelues ka përcaktim dhe kryen detyra të veçanta nga neni 9, paragrafi 1 pikat 2, 4, 5, 6, 7 dhe 10 të këtij ligji në nivel shtetëror dhe lokal;

2) të propozojë programe (projekte) të cilat do t'i realizojë veçanërisht nga mbrojtja nga invaliditeti me të cilat do të ndihmohet jeta e pavarur e grupit të caktuar të personave me invaliditet;

3) ka kuadër të përgatitur profesionalisht për udhëheqjen e programeve (projekteve) sociale nga mbrojtja e invaliditetit, sociale shëndetësore dhe mbrojtje tjetër e personave invalidë;

4) propozon programe (projekte) sociale speciale për persona me invaliditet, të anëtarësuar dhe të paanëtarësuar dhe

5) nëse anëtarësojnë së paku 40 persona nga të cilët 95% persona me invaliditet të llojit të njëjtë, ose 95% persona me invaliditet të llojit të ndryshëm, por megjithatë me të drejta ose status shoqëror të njëjtë, të cilët vepronë në interes publik të rajonit të mbrojtjes nga invaliditeti (në tekstin e mëtejshëm: organizata e invalidëve) në pajtim me ligjin.

#### Neni 11

### Procedura për ndarjen e statusit organizatës së invalidëve

Shoqata ose lidhja i paraqesin kërkesë me shkrim për të fituar status të organizatës së invalidëve Ministrisë e Punës dhe Politikës Sociale.

Organizata e invalidëve është e obliguar të regjistrohet në Regjistrin qendror në rajonin ku e ka selinë.

#### Neni 12

Shoqata ose lidhja kërkesës me shkrim për të fituar statusin e organizatës së invalidëve duhet t'i bashkëngjisin:

1) dëshminë e regjistrimit, emrin, selinë dhe përfaqësuesit e shoqatës ose lidhjes dhe

2) dëshminë për plotësimin e kushteve për fitimin e statusit të organizatës së invalidëve.

Kërkesa paraqitet në pajtim me nenin 11, paragrafin 1 të këtij ligji.

#### Neni 13

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale me aktvendim vendos për ndarjen e statusit organizatës së invalidëve, në bazë të mendimit paraprak të Komisionit.

Komisionin nga paragrafi 1 i këtij neni e formon ministri në përbërje të tre anëtarëve, nga të cilët një anëtar i komisionit është me propozim të Këshillit nacional të organizatave të invalidëve të Maqedonisë nga neni 26 i këtij ligji.

Komisioni e përgatit mendimin për fitimin e statusit të organizatës së invalidëve në bazë të kërkesave të shqyrtuara dhe mendimit paraprak të marrë nga Trupi nacional koordinues për të drejta të barabarta të personave me invaliditet në Republikën e Maqedonisë dhe Këshillin nacional i organizatave të invalidëve në Republikën e Maqedonisë.

#### Neni 14

### Ndërprerja e statusit të organizatës së invalidëve

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale me aktvendim vendos për ndërprerjen e statusit të organizatës së invalidëve, nëse:

- organizata e invalidëve paraqet kërkesë për ndërprerjen e statusit;

- organizata e invalidëve nuk i plotëson më kushtet për fitimin e statusit të organizatës së invalidëve sipas këtij ligji dhe sipas Ligjit për shoqatat e qytetarëve dhe fondacioneve;

- nëse organizata nuk vepron në pajtim me nenin 3 të këtij ligji;

- nëse shoqata ose lidhja janë shlyer nga regjistri i shoqatave të qytetarëve dhe

- nëse organizata e invalidëve është tërhequr ose është përjashtuar nga organizata e invalidëve, e cila si lidhje e shoqatave e ka fituar statusin e organizatës së invalidëve.

Kundër aktvendimit nga neni 13 paragrafi 1 i këtij ligji, mund të dorëzohet ankesë te komisioni i shkallës së dytë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, kompetent për çështje të mbrojtjes sociale.

## Neni 15

Në procedurën për ndërprerje të statusit të organizatës së invalidëve, aktvendimi nga neni 14 paragrafi 1 i këtij neni merret në bazë të mendimit paraprak të komisionit, të përgatitur në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të këtij ligji.

Në bazë të vendimit të plotfuqishëm për shlyerje nga regjistri i organizatave të invalidëve, shoqatës ose lidhjes së shoqatave u ndërpritet statusi i organizatës së invalidëve.

## Neni 16

**Regjistri i organizatave të invalidëve**

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e mban regjistrin e organizatave të invalidëve.

Regjistri i organizatave të invalidëve i përmban këto dhëna:

- numrin rendor të regjistrimit,
- datën e regjistrimit,
- emrin e organizatës së invalidëve,
- selinë e organizatës së invalidëve,
- emrin personal të përfaqësuesit të organizatës së invalidëve,
- numrin dhe datën e vendimit për fitimin e statusit të organizatës së invalidëve, dhe
- datën e ndërprerjes së statusit të organizatës së invalidëve.

Organizatata e invalidëve janë të obliguara që Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe regjistrin qendror t'i dorëzojnë njoftim për ndryshimet e të dhënave të cilat mbahen në regjistrin e organizatave të invalidëve, më së voni 15 ditë nga dita e ndryshimeve të bëra.

## III. ORGANIZATAT NACIONALE TË INVALIDËVE

## Neni 17

**Statusi i organizatave nacionale të invalidëve**

Organizata e invalidëve fiton statusin e organizatës nacionale të invalidëve nëse punon në territorin e Republikës së Maqedonisë, si dhe në plan ndërkombëtar dhe t'i paraqesë personat me lloj të caktuar të invaliditetit pa dallim të përkatësisë së tyre fetare, kombëtare dhe racore.

Krahas kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni organizata e invalidëve është e nevojshme që të ketë:

- 1) statusin e organizatës së invalidëve;
- 2) së paku 15 shoqata komunale, ndërkomunale dhe qytetare të cilat veprojnë në tërë territorin e shtetit;
- 3) t'i kryej; detyrat nga neni 9, paragrafi 1, pikat 1, 9 dhe 12, dhe nga neni 10 pika 1 të këtij ligji;
- 4) në organizatën e vet të ketë të përfshirë 95% persona invalidë të cilët janë me lloj të njëjtë invaliditeti, ose 95% persona invalidë me invaliditet të llojit të ndryshëm, por aktivitetet e tyre të jenë të orientuara kah plotësimi e nevojave të njëjta, të përbashkëta dhe të veçanta;
- 5) organizim që të mund të veprojnë në të gjitha sferat e jetës së personave me invaliditet të caktuar, veçanërisht në fushën e arsimit, shëndetësisë, punësimit, mbrojtjes sociale, jetës kulturore, aktiviteteve sportive rekreative dhe të tjera;
- 6) për shkak të nevojave specifike të anëtarëve të vet të jetë e aftësuar t'i realizojë nevojat për furnizim të mjeteve ndihmëse për anëtarët e vet, sigurimin e shoqërujesit, sigurimin e interpretuesve të gjuhës me shenja, t'i aftësojë anëtarët për orientim dhe integrim social, anulimin e barrierave arkitektonike, rregullimin gjatë punësimit të personave me invaliditet, ngritjen e iniciativave për përparimin e mbrojtjes sociale dhe të drejtave të personave me invaliditet, kujdesin për familjen, nevojat për organizimin e jetës kulturore, sportive dhe rekreative, zgjidhjen e problemeve të përditshme jetësore me të cilat ndeshen personat me invaliditet dhe të tjera;

7) ekzistimi i kushteve të përshtatshme hapësinore për kryerjen e punëve administrative teknike për nevojat e personave me invaliditet dhe kushteve hapësinore për aktivitete të klubeve të personave me invaliditet dhe

8) anëtarësim në asociacionet ndërkombëtare të personave me invaliditet.

## Neni 18

**Kushtet e përgjithshme**

Statutin e Organizatës nacionale të invalidëve mund të marrë vetëm një organizatë e invalidëve për lloj të caktuar të invaliditetit, në pajtim me nenin 20 të këtij ligji.

## Neni 19

Organizata nacionale e invalidëve ka për detyrë:

- t'i paraqesë dhe t'i përfaqësojë personat me invaliditet dhe interesat e tyre në komunikim me organet shtetërore në Republikën e Maqedonisë dhe në nivel ndërkombëtar,
- në pajtim me dispozitat të propozojë përfaqësues të personave me invaliditet në trupat punues në organet shtetërore, të cilat i përpunojnë çështjet në lidhje me personat me invaliditet dhe
- propozon ose emëron përfaqësues të personave me invaliditet në organet e shoqatave dhe organizatave ndërkombëtare homogjene.

**Kushtet e veçanta**

## Neni 20

**Procedura për marrjen e statusit të Organizatës nacionale të invalidëve**

Organizatë nacionale e invalidëve mund të jetë ajo organizatë e cila i plotëson kushtet e veçanta në vijim:

- 1) të ketë të regjistruar në organizatën e vet së paku 300 anëtarë me invaliditet të përcaktuar në bazë të udhëzimit dhe mendimit të organit kompetent;
- 2) të ketë së paku 15 shoqata ndërkomunale dhe qytetare të cilat vullnetarisht janë bashkuar në një organizatë të vetme të invalidëve;
- 3) të ketë të siguruar hapësirë të përshtatshme për punë dhe aktivitete, në së paku 15 shoqata ndërkomunale dhe qytetare;
- 4) të ketë kuadër të aftësuar profesional në së paku 15 shoqata ndërkomunale qytetare (varësisht nga lloji i invaliditetit: njohja e gjuhës me shenja të personave të shurdhër, profil përkatës të kuadrove për punë me të verbër, persona me të pengesa intelektuale dhe persona me lloje tjera të invaliditetit) dhe
- 5) Nga dita e themelimit të tyre të ketë së paku 5 vjet periudhë të veprimtarisë aktive në realizimin e mbrojtjes dhe të drejtave të personave me invaliditet.

## Neni 21

Për marrjen e statusit të Organizatës nacionale të invalidëve, organizata e invalidëve i paraqet kërkesë me shkrim Ministrisë e Punës dhe Politikës Sociale.

Komisioni nga neni 13 i këtij ligji është kompetent për pranimin dhe ndërprerjen e statusit të Organizatës nacionale të invalidëve.

## Neni 22

Kërkesës me shkrim për njohjen e statusit të Organizatës nacionale të invalidëve duhet t'i bashkëngjiten:

- 1) Aktvendimi për pranimin e statusit të organizatës së invalidëve,
- 2) Raporti për kryerjen e detyrave nga pikat 1, 9 dhe 12 nga neni 9 i këtij ligji, dhe

3) Deklarata për numrin e personave të anëtarësuar me lloj të njëjtë invaliditeti dhe përfaqësuesit e tyre ligjor ose

4) Deklarata për numrin e personave të anëtarësuar me invaliditet më të drejta të njëjta dhe me nevoja të veçanta.

#### Neni 23

### Pushimi me punë i Organizatës nacionale të invalidëve

Organizata nacionale e invalidëve pushon me punë (e humb statusin) nëse nuk përmbushen dispozitat nga Ligji për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet dhe të këtij ligji dhe nëse me aktvendim shlyhet nga regjistri gjyqësor.

#### Neni 24

Organizata nacionale e invalidëve pushon me punë nëse krahas dispozitave të Ligjit për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet nuk i përmbush detyrat nga neni 19 i këtij ligji.

#### Neni 25

### Regjistri i Organizatës nacionale të invalidëve

Ministria e Punës dhe Politikë Sociale e udhëheq regjistrin e Organizatës nacionale të invalidëve.

Regjistri i organizatave të invalidëve i përmban këto të dhëna:

- numrin rendor të regjistrimit,
- datën e regjistrimit,
- emrin e Organizatës nacionale të invalidëve,
- numrin dhe datën e vendimit për pranimin e statusit të Organizatës nacionale të invalidëve dhe
- datën e pushimit me punë të Organizatës nacionale të invalidëve.

Organizata nacionale e invalidëve është e detyruar që regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë t'ia bëjë të njohur ndryshimet e të gjitha të dhënave të cilat mbahen në regjistrin e Organizatës nacionale të invalidëve në pajtim me dispozitat nga Ligji për shoqatat qytetare dhe fondacionet.

#### Neni 26

### Këshilli nacional i organizatave të invalidëve të Maqedonisë

Organizatave nacionale të invalidëve mund të lidhen në Këshillin nacional të organizatave invalidore të Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: KNOIM)

Këshilli nacional i organizatave invalidore të Maqedonisë themelohet në bazë të marrëveshjes ndërmjet Organizatës nacionale të invalidëve nga paragrafi 1 i këtij neni, me të cilën proporcionalisht përcaktohen detyrat e KNOIM ndërmjet Organizatave nacionale invalidore të lidhura. Marrëveshja i dorëzohet Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për shkak të evidentimit në regjistrin dhe e njëjta i dorëzohet Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

Në KNOIM të gjitha anëtarët janë të barabarta. Në KNOIM mund të inkuadrohet çdo Organizatë nacionale e invalidëve, e cila e dëshiron këtë dhe vepron në nivel nacional. KNOIM është i detyruar për të gjitha ndryshimet ta njoftojë Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë në pajtim me dispozitat nga Ligji për shoqatat qytetare dhe fondacionet.

#### Neni 27

### Qëllimi i themelimit të KNOIM

KNOIM i harmonizon interesat e të gjithë personave me invaliditet në shtet nëpërmjet arritjes së autonomisë të çdo organizate dhe e përfaqëson në dialogun ndërmjet organizatave të invalidëve dhe në dialogun me shoqatat profesionale, organet shtetërore, institucionet publike dhe publikun më të gjerë.

KNOIM propozon, në pajtim me rregullat, përfaqësues grupor të personave me invaliditet në organet shtetërore dhe institucionet e tjera publike, si dhe në organet e organizatave dhe shoqatave ndërkombëtare dhe kryen aktivitetet e tjera grupore.

### V. FINANCIMI DHE PRONËSIA E ORGANIZATAVE TË INVALIDËVE, I ORGANIZATAVE NACIONALE TË INVALIDËVE DHE KNOIM-it

#### Neni 28

Organizata e invalidëve për aktivitetin e saj financohet nga:

- kuotizacioni,
- Buxheti i Republikës së Maqedonisë në pajtim me Vendimin për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së mjeteve financiare shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve dhe Listës së shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve,
- Buxheti i Republikës së Maqedonisë nga mjetet e lojërave të fatit në pajtim me vendimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për shpërndarjen e këtyre mjeteve, për çka i dorëzojnë kërkesë dhe program Ministrisë së Financave për vitin rrjedhës;
- buxheti i Vetadministrimit lokal,
- në bazë të të drejtave pronësore dhe aktiviteteve të organizatës së invalidëve;
- dhuratat dhe pasuritë trashëgimore,
- të ardhurat e donatorëve dhe
- burimet e tjera të përcaktuara me ligj.

#### Neni 29

Organizatave nacionale të invalidëve financohen nga:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë nga mjetet e lojërave të fatit në pajtim me vendimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për shpërndarjen e këtyre mjeteve, për çka i dorëzojnë kërkesë dhe program Ministrisë së Financave për vitin rrjedhës,
- Buxheti i Republikës së Maqedonisë, në bazë të projekteve me të cilat aplikojnë në shpallje që e shpallin ministritë kompetente dhe
- nga burimet e tjera të përcaktuara me ligj.

Organizatave nacionale të invalidëve nga mjetet të cilat i marrin në pajtim me paragrafin 1 alinën 1 të këtij neni, i financojnë organizatat invalidore të komunave të cilat janë vullnetarisht të shoqëruara në Organizatën nacionale të invalidëve.

#### Neni 30

### Këshilli nacional i organizatave të invalidëve të Maqedonisë

KNOIM financohet nga Organizatat nacionale të invalidëve të cilat me marrëveshje janë të lidhura në KNOIM në pajtim me nenin 26 të këtij ligji.

Në Marrëveshjen për lidhjen e organizatave nacionale të invalidëve në KNOIM përcaktohet edhe përqindja që duhet ta ndajë secila Organizatë nacionale e invalidëve nga mjetet të cilat i merr në pajtim me nenin 29 alinën 1 të këtij ligji.

## Neni 31

Organizata e invalidëve, Organizata nacionale e invalidëve dhe Këshilli nacional i organizatave invalidore të Maqedonisë doemos duhet ta hartojnë dokumentin financiar për planifikime, punë financiare dhe lajmërim vjetor, kështu që veçanërisht të evidentohen burimet financiare, shpenzimet për punë dhe për realizimin e programeve të tyre vjetore.

Të dhënat paraqiten në përputhje me rregullat për punë financiare.

## Neni 32

Raporti vjetor për punën e organizatës së invalidëve dhe Organizatës nacionale të invalidëve e shqyrton dhe e aprovon organi kompetent i organizatës së invalidëve.

Organizata e invalidëve iu dorëzon raportin vjetor për punën e organizatës, e autorizuar për përpunimin dhe shpalljen e të dhënave, deri në ditën e fundit të muajit shkurt në vitin rrjedhës, personave fizikë dhe juridikë, të cilët i sigurojnë mjetet e organizatave të invalidëve, ndërsa pastaj për përdorimin e atyre mjeteve, organizata e invalidëve e njofton Organizatën nacionale të invalidëve dhe organet e tjera kompetente.

Organizatata nacionale të invalidëve i dorëzojnë raport vjetor për punë me raportin financiar Këshillit nacional, ndërsa Këshilli nacional raportin ia dorëzon ministrisë kompetente dhe donatorëve të mjeteve financiare.

## Neni 33

**Ekonomizim me pronën**

Organizata e invalidëve, Organizata nacionale e invalidëve dhe Këshilli nacional i organizatave të invalidëve disponojnë dhe udhëheqin me pronën dhe mjetet monetare në pajtim me Statutin, Ligjin e shoqatave të qytetarëve dhe fondacionet dhe me ligj tjetër.

## Neni 34

Pas pushimit me punë të organizatës së invalidëve për udhëheqje me pronën e saj, zbatohen dispozitat nga Ligji për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet.

## Neni 35

**Mbikëqyrja mbi ligjshmërinë e punës**

Mbikëqyrje mbi zbatimin e programeve dhe investimeve mund të bëjnë, krahas organeve kompetente të organizatës, gjithashtu dhe organet profesionale të cilat janë të autorizuar nga personat fizikë dhe juridikë, të cilat i ndajnë mjete organizatës së invalidëve (sponsorë, donatorë dhe ngjashëm).

Mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e punës dhe përmbushjen e dispozitave të këtij ligji dhe Ligjit për shoqata të qytetarëve dhe fondacionet ndaj organizatës së invalidëve, Organizatës nacionale të invalidëve dhe Këshillit nacional të organizatës së invalidëve e bën Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, ndërsa mbikëqyrjen e punës financiare e bën Ministria e Financave dhe Revizori shtetëror për punë financiare.

## VI. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

## Neni 36

**Gjobë**

Gjobë në vlerë prej 2.500 deri më 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje organizatës së invalidëve, Organizatës nacionale të invalidëve dhe Këshillit nacional të organizatave të invalidëve, nëse:

- ndërmerr aktivitete me të cilat i pengon qëllimet e veprimt (nenet 8, 19 dhe 27),
- nuk lajmëron për ndryshimin e të dhënave (neni 25),
- nuk harton dokumentacion financiar (neni 31) dhe
- nuk dorëzon program vjetor dhe raport financiar (neni 32).

Gjobë në shumë prej 250 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në organizatën e invalidëve, Organizatën nacionale të invalidëve dhe Këshillit nacional të organizatave të invalidëve.

## VII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

## Neni 37

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**1668.**

Врз основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

**У К А З****ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА МУЗЕИТЕ**

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за музеите, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 14 јули 2008 година.

Бр. 07-2887/1  
14 јули 2008 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
**Бранко Црвенковски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
**Трајко Вељаноски, с.р.**

**ЗАКОН****ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА МУЗЕИТЕ**

## Член 1

Во Законот за музеите („Службен весник на Република Македонија“ број 66/2004), насловот на Главата XII „Казнени одредби“ се менува и гласи: „Прекршочни одредби“.

## Член 2

Во членот 45 став (1) зборовите: „Со парична казна од 100.000 до 200.000 денари ќе се казни за прекршок правното лице ако:“ се заменуваат со зборовите: „Глоба во износ од 3.000 до 5.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на правното лице кое:“.

Во ставот (2) зборовите: „Со парична казна од 10.000 до 30.000 денари ќе се казни за прекршокот од ставот (1) на овој член и одговорното лице во правното лице“ се заменуваат со зборовите: „Глоба во износ од 800 до 1.500 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член и на одговорното лице во правното лице“.